



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 556/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) me seli në Graçanicë, për shkak të gabimeve teknike në Qendrën e Votimit nr. 3405/01r, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuar ankesa subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik SLS, ne te cilën pretendohet se kanë ndodhur gabime teknike gjatë regjistrimit të rezultateve zgjedhore me ndërrimin e vendeve, gabimisht janë regjistruar 212 vota në rubrikën nr. 37 (Kosova Turk Birligi), ku sipas parashtruesit të ankesës këto vota është dashur të jenë regjistruar në rubrikën 38 të SLS-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 105 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

105.1 Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda 24 orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku*

mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh, se pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se është bërë shkelja e theksuar në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk është ofruar dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 556/2010 më datën 16.12.2010.

